

VENDIM
Nr. 113, datë 21.4.2026

**MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT LIDHUR ME
KËRKESËN E SHOQËRISË “SUNNY SIDE ENERGY” SHPK PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 14, pika 3, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.4.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 856/9 prot., datë 17.4.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Sunny Side Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Sunny Side Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 856 prot., datë 9.3.2026, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 83, datë 19.3.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 20.3.2026 dhe 21.3.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga palët e treta (data 30.3.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 856/4 prot., datë 25.3.2026, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës së licencimit, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim.

- Me *email*-in e protokolluar në ERE me nr. 856/7 prot., datë 14.4.2026, dhe me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 856/8 prot., datë 15.4.2026, shoqëria ka depozituar dokumentacion/informacion plotësues në lidhje dëshminë e penaliatetit të vetë shoqërisë, strukturën organizative, mbështetjen financiare, planin e biznesit dhe disponimin e zyrave përfaqësuese të furnizimit, por nga analizimi i këtij dokumentacioni rezulton se duhet të depozitohet dhe vërtetimi i gjendjes gjyqësore për administratorin, vendimi i organeve drejtuese për dedikimin e fondeve për ushtrimin e veprimtarisë dhe kontrata për huapërdorjen e zyrave në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin.

Zgjatja e vendimmarrjes

- Në nenin 14, pika 2 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, përcaktohet, se: për centralet e lidhur drejtpërdrejtë me rrjetin e shpërndarjes dhe për të gjitha licencat e tjera, Bordi merr vendim jo me vonë se 30 ditë nga data e publikimit të parë të njoftimit në shtyp për aplikimin për licencë”. Në nenin 14, pika 3, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, parashikohet, se: “Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e

afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë”.

- Me qëllim për t’i dhënë mundësinë shoqërisë për të plotësuar dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi, vlerësohet që të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin e munguar brenda 20 (njëzet) ditëve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Brenda 20 (njëzet) ditëve, shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacionin/dokumentacionin e munguar të aplikimit.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “Sunny Side Energy” sh.p.k., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti